



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

ARTIKUJT

AKSESORË REFLEKTIVË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

**DORASHKA CEREMONIALE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
SHTETIT**

DORASHKA PREJ LËKURE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

**JELEKU OPERACIONAL MULTIFUNKSIONAL PËR PUNONJËSIT E
POLICISË SË SHTETIT**

JELEK SHPËTIMI PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

**JELEK PREZANTUES OPERACIONAL PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
SHTETIT**

**RRIPË I UNIFORMËS CEREMONIALE, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
SHTETIT**

**RRIPË OPERACIONAL MULTIFUNKSIONAL PËR PUNONJËSIT E
POLICISË SË SHTETIT**

**RRIPË I PANTALLONAVE TË UNIFORMËS, PËR PUNONJËSIT E
POLICISË SË SHTETIT**

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë hartuar në përputhje me V.K.M-në Nr.55 dt.27.01.2016 dhe V.K.M-në Nr.287 dt.10.05.2019. Këto Specifikime Teknike parashtrojnë në mënyrë të detajuar kërkesat themelore teknike të domosdoshme për ndërtimin e prototipit dhe prodhimin e artikullit.

Specifikimet Teknike përcaktojnë gjithashtu edhe kërkesat teknike të aksesorëve që duhet të shoqërojnë artikullin.




Prodhuesit janë të detyruar që t'i zbatojnë të gjitha specifikimet teknike të këtij dokumenti.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Aksesorë reflektivë

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikujve aksesorë reflektivë duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Tekstili për jelekun reflektiv		
Ngjyra	e gjelbër (green lime) Sipas spektrit CIELCH 79,89.881,119.910	
	blu Sipas spektrit CIELCH 31,35.114,273.853	
	e kuqe në vishnje Sipas spektrit CIELCH 41,70.780,28.754	
Përbërja %	100 % poliamid	
Thurja	Rrjetë	
Masa gr/m ² (±5%)	200 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4 - 5 (shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 20000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5	
AZO Ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem	
pH	4.0 – 9	

Tekstili për mbulesën e kapelës së uniformës dhe mëngoreve.		
Ngjyra	E gjelbërt (green lime) Sipas spektrit CIELCH 79,89.881,119.910	
Përbërja %	100% poliamid	
Thurja	Diagonal	
Masa gr/m ² (±5%)	150 gr/m ²	
Depërtueshmëria e ujit	mbi 10,000 mm	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 - 5 (shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 20000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5	
AZO Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 – 9	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se - nota 6: shumë e mirë*.


Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë të gjelbër, blu dhe të kuqe, do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):


- elementë Velcro që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të artikujve.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikujve.

Jeleku

Tekstile		
Tekstili për xhepat dhe arnën e shkrimit në shpinë	Ngjyra	e zezë
	Përbërja	100 % poliamid
	Pesha ($\pm 5\%$)	250 gr/m ²
	Thurja	Oksford
	Trajtimi	Hidrofbik
Tekstil prej gome për jastëkun e qytës. Vetëm për jelekun e kuq.	Ngjyra	e zezë
	Përbërja	100% polivinil kloruri PVC
Mbushje për jastëkun e qytës. Vetëm për jelekun e kuq.	Përbërja	100% polister
	Trashësia (sipas standardit për jelek taktik)	≈ 1 cm
Aksesore të tjerë		
Zinxhiri për mbylljen e jelekut 	Lloji	standard, me hapje të poshtme
	Madhësia e dhëmbëzave	8 VS or 10VF
	Përbërja e tekstilit	100% poliestër
	Përbërja e dhëmbëzave	100% acetal
	Ngjyra	e zezë
Unaza të llojit "D" 	Përbërja	100% hekur i trajtuar me agjent kundër ndryshkut
	Ngjyra	e zezë
Kapëse për këllëfin e pistoletës. 	Përbërja	100 % Acetat
	Ngjyra	E zezë
	Lloji	për përdorim taktik
Fileto për bordurat e jelekut, kapakëve të xhepave dhe arnës në shpinë. 	Përbërja	100 % poliestër
	Gjerësia	1.5 cm (0.7 cm e qepur)
	Ngjyra	E zezë
Perçina për kapjen e xhepave ne jelek 	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)
	Ngjyra	e zezë pa shkëlqim
	Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të montohen.	

Shirit taktik për ndërtimin e sistemit “PALS” tek jelekët dhe pjesët e xhepave. 	Ngjyra	e gjelbër (njësoj si jeleku)
		blu (njësoj si jeleku)
		e kuqe (njësoj si jeleku)
		e zezë (si xhepat)
	Përbërja	100% poliamide
	Trashësia	2.5 cm
Shiriti reflektiv 	Ngjyra	gri argjendi
	Gjerësia	≈ 5 cm
	Përbërja	100 % poliester
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit EN ISO 20471:2013	
	Materiali duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.	
	Shiriti duhet duket nga një distancë prej mbi 150 m.	
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% poliester
	Numri	60 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	e zezë
		e gjelbër (njësoj si jeleku)
		blu (njësoj si jeleku)
e kuqe (njësoj si jeleku)		

Velcro			
Element <i>Velcro</i> femër/mashkull për mbylljen e jelekut dhe xhepave.    	Përmasat <i>Velcro</i>	për mbylljen e xhepave	sipas formes së kapakut të xhepit
		<i>Velcro</i> për gradën e gjoksit dhe numrit. (2 copë/jelek)	8.6 cm x 3 cm
		për mbylljen e supeve	sipas formës së supeve
		për mbylljen e hijeve	shirit me gjerësi 4 cm
	Përbërja	100% fibra poliamide	
Ngjyra	e gjelbër (njësoj si jeleku)		
	blu (njësoj si jeleku)		
	e kuqe (njësoj si jeleku)		
	e zezë (si xhepat)		
Trashësia e dy shiritave të bashkuar			± 3 mm
Masa lineare		41 g/m ± 5 %	
Trashësia, pjesa <i>femër</i>		2.2 mm	
Trashësia, pjesa <i>mashkull</i>		1.6 mm	
Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme			
E ftohtë		- 30 °C	
E nxehtë	pika e dobësimit: 180 °C		
	pika e shkrirjes: 210 – 250 °C		
Qëndrueshmëria e ngjyrës			
Në larje		jo më pak se 3	
Në ujë të nxehtë			
Në djersë			
Në fërkim			

Stampa		
Shkrimi POLICIA, në kapakun e xhepi 	Stampim me material/bojë reflektive	
	Ngjyra	gri, argjend
	Përmasat referencë	≈ 2cm x 11 cm
	Lloji i germës	Myriad Pro Bold
	Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje.	
Shkrimi POLICIA, mbrapa 	Stampim me material/bojë reflektive	
	Ngjyra	gri, argjend
	Përmasat referencë	≈ 4.2 cm x 22 cm
	Lloji i germës	Myriad Pro Bold
	Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje.	

Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, për mirëmbajtjen, masës së artikullit dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë/e zezë

Mbulesa e kapeles së uniformës për meshkuj dhe për femra

Shirit reflektiv								
Shirit reflektiv 	Ngjyra	gri argjendi						
	Gjerësia	≈5 cm						
	Përbërja	100 % poliester						
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013							
	Materiali duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.							
Shiriti duhet duket nga një distancë prej mbi 150 m.								
Filli								
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% poliester						
	Numri	80 Nm						
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N						
	Ngjyra	e gjelbër (njësoj si tekstili)						
		gri						
Shirit për termosaldimin e qepjeve të mbulesës. Shirit per termosaldimin e qepjeve 	Shirit duhet të jetë me 3 shtresa: najlon, PTFE, shtresë termoadesive <table><tr><td>Ngjyra</td><td>si tekstili</td></tr><tr><td>Gjerësia</td><td>2 cm</td></tr><tr><td>Trashësia</td><td>0.2 mm</td></tr></table> Shirit duhet të ketë ajërosje dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.		Ngjyra	si tekstili	Gjerësia	2 cm	Trashësia	0.2 mm
Ngjyra	si tekstili							
Gjerësia	2 cm							
Trashësia	0.2 mm							
Shtresë plastike transparente								
Shtresë plastike transparente për dallimin e emblemës së kapeles.	Përbërja	100% PVC						
	Trashësia	1 mm						
Llastik								
Llastik 	Përbërja	100 % poliester						
	Gjerësia	1 cm						
Etiketa								

Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, për mirëmbajtjen, masës së artikullit dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

Mëngoret

Shirit reflektiv		
Shirit reflektiv 	Ngjyra	gri argjendi
	Gjerësia	≈ 5 cm
	Përbërja	100 % poliester
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013	
	Materiali duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.	
Shiriti duhet duket nga një distancë prej mbi 150 m.		
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% poliestër
	Numri	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	si tekstili
Shirit për termosaldimin e qepjeve të mëngores. Shirit për termosaldimin e qepjeve 	Me 3 shtresa	najlon
		PTFE
		shtresë termoadezive
	Ngjyra	si tekstili
	Gjerësia	2 cm
	Trashësia	0.2 mm
	Shirit duhet të ketë ajërosje dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.	
	Llastik	
Llastik 	Përbërja	100 % poliester
	Gjerësia	1 cm
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	e bardhë

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikujve *aksesorë reflektivë*.

Qese polietileni për paketimin e secilit aksesorë.
Kuti kartoni për paketimin e secilit prej aksesorëve.

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuar.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikujt aksesorë reflektivë do të porositen dhe do të prodhohen në masat:

- Jelekët reflektivë në katër masa standarde: XS/S - M/L - XL/XXL - XXXL
- Mbulesa për kapelen e uniformës për meshkuj (në tre masat kryesore të kapeles):
1 (53/54/55), 2 (56/57/58), 3 (59/60/61)
- Mbulesa për kapelen e uniformës për femra (në tre masat kryesore të kapeles):
1 (53/54/55), 2 (56/57/58), 3 (59/60/61)
- Mëngore (masë unike): 19 x 28 cm

Aksesorët do të prodhohen në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.


Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Perimetri i kokës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
7	Perimetri i kyçit	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.
14	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës	cm.
16	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
	Gjatësia e supit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCE

		
Sipas spektrit CIELCH 31,35.114,273.853 Ngjyra blu për tekstin dhe materialet ndihmëse të jelekut.	Sipas spektrit CIELCH 79,89.881,119.910 Ngjyra e gjelbër (green lime) për tekstin dhe materialet ndihmëse të jelekut dhe aksesorëve reflektivë (mëngoreve dhe mbulesës së kapeles)	Sipas spektrit CIELCH 41,70.780,28.754 Ngjyra e kuqe për tekstin dhe materialet ndihmëse të jelekut.
		
Sipas spektrit CIELCH 73, 0.743,200.028 Ngjyra gri për shiritin dhe stampën reflektive (fluoreshente)	Sipas spektrit CIELCH 17, 2.875, 65.882 Ngjyra e zezë për tekstin e stampës në shpinë, xhepave dhe shiritave për profilimin e bordurave.	
Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.		
Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.		

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *aksesorë reflektivë*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përberëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhueshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përberëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e artikullit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.


5. NDËRTIMI


Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të artikujve

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

Jelevu








Jeleku duhet të plotësojë të gjitha parametrat teknikë dhe cilësorë në kategorinë e veshjeve taktike dhe me vizibilitet të lartë. Jeleku mund të përdoret me ose pa aksesoret shoqërues, në varësi të detyrës së punonjësit të Policisë së Shtetit.

Pjesët përbërëse të jelekut:

- Dy pjesët e përparme
 - Pjesa e pasme
 - Jastëku i qytës (vetëm për jelekun e kuq)
 - Shiritat taktikë (sistemi PALS)
 - Shiritat reflektivë
 - Stampat
 - Elementët *Velcro*
 - Xhepat
- Në të gjitha pjesët e tij, trupi i jelekut duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili rrjetë të qepura me njëra tjetrën dhe të profiluara me shirit me ngjyrë të zezë.
- Mbyllja e jelekut duhet të bëhet me anë të zinxhirit.
- Jeleku duhet të pajiset me elementë *Velcro* tek supet dhe të ijët për të mundësuar përshtatjen e tij sipas masës së trupit.



Sistemi i mbylljes së jelekut dhe vendosja e elementëve Velcro


- Jeleku me ngjyrë të kuqe duhet të pajiset në anën e djathtë të gjoksit me shtrojën prej gome për jastëkun e qytës. Jastëku i qytës duhet të jetë i mbushur nga brenda me një shtresë të butë mbrojtëse dhe të përforcohet me tegela qepës vertikale, të cilët krijojnë sipërfaqe të valëzuar të shtrojës.
- Jeleku duhet të pajiset me sistemin “PALS” (Pouch Attachment Leader System – Sistemi me shirita i vendosjes së xhepave), me shirita taktikë, në kraharor, supe dhe ijë për fiksimin e xhepave, këllëfit të pistoletës, kamerave, radiove, ndriçuesve elektrikë dhe pajisjeve të tjera në përdorim nga *Policia e Shtetit*. Shiritat taktikë duhet të kenë qepje vertikale të përforcuara çdo 38/40 mm.



Ndërtimi i sistemit “PALS”


- Jeleku duhet të pajiset me dy shirita reflektivë të qepur përgjatë perimetrit tërthor të trupit dhe dy shirita reflektivë të qepur në mënyrë vertikale tek zona e supeve dhe shpatullave.

Shkrimi “POLICIA”, përpara, në kapakun e xhepit.



- Në pjesën e përparme të jelekut, në xhepin e sipërm në të majtë, duhet të stampohet fjala POLICIA.
- Germat e fjalës duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.
- Fjala nuk duhet të shtrembërohet ose deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Përmasat e shkrimit të vogël duhet të jenë për të dyja gjinitë njësoj, 2 cm x 11 cm.
- Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri, si shiriti reflektiv.


Shkrimi "POLICIA", mbrapa.



- Në pjesën e pasme të jelekut, në qendër të shpatullave, duhet të stampohet fjala POLICIA.
- Gërmat e fjalës duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.
- Fjala nuk duhet të shtrembërohet ose deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i gërmës.
- Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri, si shiriti reflektiv.
- Tekstili mbi të cilin do të stampohet fjala "POLICIA" duhet të ketë ngjyrë të zezë dhe duhet të jetë i profiluar me shirit, po ashtu me ngjyrë të zezë.

Elementë Velcro


Secili jelek duhet të pajiset me dy *Velcro* femër për nr e identifikimit dhe për gradën e gjoksit. Ngjyra e *velcro*-ve duhet të jetë sipas ngjyrës së jelekut.



Xhepat e çmontueshëm

		Xhepi i madh	
		Sasia	1 për jelek
		Përmasat e xhepit	≈ 15x21x4 cm
		Përmasat e kapakut	≈ 6 x 15.5 cm
		Sistemi i kapjes	Sistemi universal "PALS"
		Mbyllja	Velcro
		Xhepi i madh duhet të jetë i përshtatshëm për mbajtjen e bllokut ose tabletës së gjobave ose mjeteve të ndryshme në përdorim nga <i>Policia e Shtetit</i>. Në anën e djathtë të xhepit duhet të qepet një shirit taktik për vendosjen e stilolapsit.	
		Xhepat e vegjël i vogël	
		Sasia	2 për jelek
		Përmasat e xhepit	≈ 15x9.5x4 cm
		Përmasat e kapakut	≈ 6 x 15.5 cm
		Sistemi i kapjes	Sistemi universal "PALS"
		Mbyllja	Velcro
		Stampa	Njëri nga xhepat duhet të ketë të stampuar mbi kapak shkrimin POLICIA .
		Xhepat duhet të jenë të përshtatshëm për mbajtjen e mjeteve të ndryshme në përdorim nga <i>Policia e Shtetit</i>.	

 	Xhepi i radios / kamerës	
	Sasia	1 copë /jelek
	Përmasat	i rregullueshëm
	Sistemi i kapjes	Sistemi universal “PALS”
	Mbyllja	Velcro
	Këllëfi i lëvizshëm për mbajtjen e radios duhet të fiksohet tek sistemi (PALS) nëpërmjet shiritave taktikë me <i>Velcro</i>. Të gjitha pjesët e këllëfit prej tekstili duhet të kenë përmasa të rregullueshme me anë të elementë <i>Velcro</i> dhe të mund të përshtaten sipas madhësisë së radios në përdorim nga punonjësi i Policisë së Shtetit.	
	Këllëfët e karikatorëve për armë automatike	
	Sasia	1 copë/jelek
	Përmasat	Duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e karikatorëve të armëve automatike në përdorim nga Policia e Shtetit
	Sistemi i kapjes	Sistemi universal “PALS”
	Mbyllja	Velcro
	Lloji	2 këllëfë bashkë
	Një këllëf duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e dy karikatorëve. Kapaku i i këllëfit duhet të jetë i pajisur me elementë <i>Velcro</i> dhe të mund të përshtaten sipas madhësisë së karikatorëve në përdorim nga punonjësi i Policisë së Shtetit. Xhepat e këllëfëve duhet të jenë të pajisur me shirita prej llastiku, të cilët pengojnë lëvizjen e lirë të karikatorëve në këllëf.	

	Këllëfët e karikatorëve të pistoletës	
	Sasia	1 për jelek
	Përmasat	standard për pistoletë
	Sistemi i kapjes	Sistemi universal "PALS"
	Mbyllja	Velcro
	Lloji	2 këllëf bashkë
Një këllëf duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e dy karikatorëve. Kapaku i i këllëfit duhet të jetë i pajisur me elementë <i>Velcro</i> dhe të mund të përshtatet sipas madhësisë së karikatorëve në përdorim nga punonjësi i <i>Policisë së Shtetit</i>. Xhepat e këllëfëve duhet të jenë të pajisur me shirita prej llastiku, të cilët pengojnë lëvizjen e lirë të karikatorëve në këllëf.		
	Këllëfi i pistoletës	
	Sasia	1 për jelek
	Përmasat	i përshtatshëm për transportin e pistoletës
	Sistemi i kapjes	Sistemi universal "PALS"
	Mbyllja	Me kapëse plastike

	Këllëfi duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e pistoletës në përdorim nga Policia e Shtetit dhe një karikator rezervë për pistoletë. Këllëfi i pistoletës duhet të jetë i pajisur me një shirit taktik dhe kapëse plastike për të penguar daljen aksidentale të pistoletës nga këllëfi. Kapaku i i këllëfit të karikatorit rezervë duhet të jetë i pajisur me elementë <i>Velcro</i> që të mund të përshtatet sipas madhësisë së karikatorëve në përdorim nga punonjësi i <i>Policisë së Shtetit</i>.
<i>KUJDES! Përmasat e të gjitha llojeve të xhepave duhet të jenë në përputhje me mjetet dhe armatimet që përdor punonjësi i Policisë së Shtetit.</i>	
<i>Mbyllja e xhepave duhet të bëhet me element <i>velcro</i> femër-mashkull dhe perçina.</i>	

MBULESA E KAPELES SË UNIFORMËS



- Mbulesa duhet të plotësojë të gjitha parametrat teknikë dhe cilësorë në kategorinë e veshjeve me vizibilitet të lartë.

Pjesët përbërëse të mbulesës:

- Tekstili fluoreshent
 - Shiritat reflektivë
 - Dritare transparente plastike
- Mbulesa duhet t'i përshtatet formës së kapelës së kostumit të uniformës në përdorim nga punonjësit e *Policisë së Shtetit*.
 - Mbulesa duhet të fiksohet tek kapela me anë të llastikut të fshehur, të qepur tek buza.
 - Në pjesën ballore këllëfi duhet të ketë një "dritare" prej materiali plastik transparent që lejon dukjen e stemës së *Policisë së Shtetit*. Përmasat e "dritares" duhet të jenë 11 x 8 cm.
 - Tek pjesa e tavanit, mbulesa duhet të pajiset me dy shirita reflektivë ngjyrë gri me gjerësi 5 cm. Shiritat duhet të qepen vertikalisht, në distancë rreth 9 cm nga njëri-tjetri, nga pjesa ballore drejt pjesës së pasme.

MËNGORE



- Mëngoret duhet të plotësojnë të gjitha parametrat teknikë dhe cilësorë në kategorinë e veshjeve me vizibilitet të lartë.
- Pjesët përbërëse të mbulesës:
 - Tekstili fluoreshent
 - Shiritat reflektivë
- Mëngoret duhet të qepen në formë tubolare. Ato duhet të kenë gjatësi rreth 28 cm dhe gjerësi rreth 19 cm.
- Mëngoret duhet të fiksohen tek krahët me anë të llastikëve të fshehur, të qepur tek anët e hapura.
- Mëngoret duhen të pajisen me dy shirita reflektivë ngjyrë gri me lartësi 5 cm, të qepur përgjatë perimetrit tërthor të krahut.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktesisht karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
- Tegelat e qepjes duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
- Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, dhe simetrikë, dhe nuk duhet të kenë shqepje ose difekte.
- Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
- Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Tegelat kryesorë tek mbrojtësia e kapeles dhe mëngoreve, duhet jenë të veshur me shirita për termosaldimin e qepjeve.
- Të gjithë elementët e aksesorëve duhet të jenë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekuroses.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i xhepave të jelekut, mbrojtëses së kapeles dhe mëngoreve duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së ujit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e artikujve është $\pm 2\%$.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fije përgjatë anëve të lira të shiritit si në *elementët "mashkull"* ashtu dhe në ato "*femër*" edhe pasi të jetë përsëritur disa herë montimi dhe çmontimi i dy pjesëve të saj.
 - Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruar. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e standardit ISO 9001-2008.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Aksesorët duhet të pajisen me nga një etiketë prej tekstili në të cilën duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa tek jeleku duhet të qepet në qendër të jakës, tek tegeli që bashkon fileton me pjesën e pasme të tij.

Etiketa tek mëngoret duhet të qepet në mëngoren e majtë nga brenda.

Etiketa për mbulesat e kapeleve do të qepet në pjesën e brendshme të saj nga brenda.

Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njëërën anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes dhe në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, masa dhe emri i artikulli.

Në momentin e dorëzimit aksesorët duhet të jenë të pastër, të palosur dhe pa njolla.

Aksesorët e palosur duhet të futen nëpër qese polietileni. Në një qese polietileni duhet të futet vetëm një artikull.

Në çdo kuti duhet të vendosen artikuj të njëjtë dhe të së njëjtës masë. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë artikujsh. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar lloji i artikullit, masa e artikullit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjites (natriban).

ANEKS - LISTA E TESTIMEVE QË DUHET TË SHOQËROJNË OFERTËN TEKNIKE TË KËTIJ ARTIKULLI DHE REFERENCAT PËR METODAT E KRYERJES SË KËTYRE TESTIMEVE

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*	
Ngjyra	EN ISO -J03 2009	Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019	Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 7211- 1: 1984	Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005	Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Depërtueshmëria e ujit	EN 20811/ EN ISO 811:2018	Tekstilet- Përcaktimi i rezistencës ndaj depërtimit të ujit
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010	Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.(pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013	Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 : 2013	Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016	Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë

		dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014	Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016	Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2000	Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013	Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
pH	EN ISO 3071:2006	
Azo ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017	
Procesi i trajtimit	EN ISO 3758	

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Dorashka ceremoniale

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *dorashka ceremoniale* është tekstili i cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	e bardhë spektri sipas CIELCH 96, 2.573, 117.861	
Përbërja	100 % <i>nylon simplex</i>	
Thurja	<i>Interlock / jersey double</i>	
Masa(± 5 %)	180-200 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4-5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4-5	
AZO Ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem	
pH	4.0 – 9	
Kujdes! Tekstili i dorashkave duhet të jetë me thurje shumë elastike dhe nuk duhet të jetë i tejdukshëm.		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4* dhe *shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (*kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse*):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë ose kapërcim të sytheve,
- trashim të fijeve,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *dorashka ceremoniale*

Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% poliestër
	Numri	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	si tekstili
Perçina		
Perçinë e bardhë pa shkëlqim 	1 copë	d: 11 mm
	Përbërja	100% PVC
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *dorashka ceremoniale*

Qese polietileni për paketimin e një palë dorashkave.
Kuti kartoni për paketimin e dorashkave.

Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikulli *dorashka ceremoniale* do të porositet dhe do të prodhohet në masat dhe sasitëqë do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Dorashkat ceremoniale duhet të prodhohen në tre masa kryesore:

Për femra: S - M - L

Për meshkuj: S - M - L

Marrja e masave trupore



Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Për femra		
16 – 17.5 cm	18- 21 cm	21.5 – 23.5 cm
S	M	L
Për meshkuj		
18.5 – 21 cm	21.5 -24 cm	24.5 – 28 cm
S	M	L

Kujdes! Perimetri i pëllëmbës do të matet në pjesën më të gjerë të saj kur pëllëmba është e hapur. Do të maten të dyja duart dhe përmasat që duhet të merren për bazë do të jenë përmasat më të mëdha që dalin nga matjet e duarve.

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra e bardhë për tekstin e dorashkave dhe të gjithë elementëve të saj sipas spektrit CIELCH 96, 2.573, 117.861

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit dorashka ceremoniale.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të gjatësisë së sythave.

Relaksimi i tekstileve të trikotuara

Tekstili i trikotuar duhet të qëndrojë i shtrirë për 24 orë para se të kalojë në procesin e prerjes.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 60 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

5. NDËRTIMI I DORASHKAVE

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të dorashkave

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Dorashkat ceremoniale për meshkuj dhe për femra duhet të jenë identike. Ato duhet të jenë të qepura mirë dhe të duken të rregullta kur të përdoren nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

Pjesët përbërëse të dorashkës:

- pjesa e kurrizit dhe e pëllëmbës
- gishti i madh
- shiritat mes gishtave
- perçina

Dorashkat ceremoniale duhet të jenë të bardha, prej *nylon simplex*, me pjesë shtesë prej tekstili mes gishtave.

Tek kurrizi i dorës duhet të qepen tre penca dekorative. Ekstremitetet e pencave duhet të jenë më afër njëra-tjetrës për nga drejtimi i kyçit dhe më larg njëra-tjetrës për nga drejtimi i gishtave.

Mbyllja e dorashkave duhet të bëhet me perçinë plastike. Qafa e dorashkës duhet të ketë një çarje me hark rreth 3 cm të gjatë nga ana e pulsit të dorës. Çarja ndihmon mbylljen e dorashkës me perçinë. Buza e lirë e qafës duhet të paloset nga brenda rreth 1 cm.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së dorashkave duhet të jenë me hap 30 shpime në 5 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e dorashkës duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e dorashkave është $\pm 2\%$.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruar. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Dorashkat duhet të pajisen me një etiketë prej tekstili. Etiketa duhet të qepet në qendër të qafës së dorashkës, tek tegeli që palos pjesën e sipërme të dorashkës. Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njërën anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes: hekurosja, larja, tharja etj, dhe në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit, masa dhe gjinia.

Në momentin e dorëzimit dorashkat duhet të jenë të pastra, të palosur dhe pa njolla.

Dorashkat e palosura, një e majtë dhe një e djathtë, duhet të futen në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen dorashka të së njëjtës masë dhe gjini. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë dorashkash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e dorashkave, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës EN ISO 105-J02:2005 Tekstilet - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J02: Vlerësimi me instrument i bardhësisë relative.
Përbërja %	EN ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	EN ISO 8388:1998 Tekstile - Pëlhura të trikotuara
Masa gr/m ²	EN ISO 3801:1977/ EN 12127:2005 Tekstilet - Pëlhurat - Përcaktimi i masës për njësi të sipërfaqes
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2:2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
pH	EN ISO 3071:2006
Azo ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
Procesi i trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Dorashka prej lëkure

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *dorashka prej lëkure* është *meshinë deleje* (me faqe natyrore), e cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	e zezë, me pak shkëlqim
Përbërja	meshinë deleje
Sipërfaqja	e lëmuar, e njëtrajtshme
Trashësia	mbi 0.7–0.8 mm
Pesha	40 gr/m ²
Regjja	kromike
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	Nota 4-5
Lagështira	16 - 18%
Hiri	4–6%
Yndyra	3–5%
Prania e oksidit të kromit	3.0%
Rezistenca ndaj plasjes për 10 MPa	Jo më pak se 0.8
Rezistenca ndaj këputjes për 10 MPa	Jo më pak se 0.9
Zgjatimi në ngarkesë për 10 MPa	15–35%
AZO Ngjyrujes	Nuk duhet të jete te pranishem
pH	3.5 - 7.5

Kërkesat e lëndës së parë meshinë deleje i cilësisë së parë janë bazuar tek Standardi Shqiptar (SSH) 1144: 1990, "Meshinat".

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e lëkurës të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të lëkurës që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i lëkurës meshinë deleje, do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e zezë e lëkurës nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e materialeve, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- prerja nga ana e mishit që nuk kalon 1/3 e trashësisë,
- gërvishtje mbi faqe,
- dëmtime nga kalbja,
- plasje të faqes nga barazimi,
- plasje e faqes nga palosja katërshe,
- gjurmë damarësh,

- ngjyrim jo i njëjlojtë,
- njolla yndyre, kromi ose ekstrakti,
- gërvishtje ose plagë të shëruara,
- pjesë të dobëta,
- vija majmërie ose rrudha të shtrira në trup e qafë,
- thellime nga rrahja,
- valëzime dhe gropëzime,
- pika ose vrima që vijnë si rezultat i pickimeve të insekteve kur kafsha është e gjallë,
- rrudha nga palosjet në kavaletë,
- shkallëzime nga barazimi
- hollime nga sharrimi,
- oksidime,
- porozitet,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të dorashkës.

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *dorashka prej lëkure*.

Astari		
Astar i brendshëm për dorashkat 	Ngjyra	E zezë
	Lloji	pellush
	Përbërja	100 % poliestër
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% pambuk
	Numri metrik	50 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	si dorashka
Fill qepës për pencat dekorative	Përbërja	100% pambuk <i>pearl</i>
	Numri	30/3 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si dorashka
Llastik		
Llastik 	Përbërja	100 % poliestër
	Ngjyra	e zezë
	Gjerësia	0.5 cm
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e zezë

- c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *dorashka prej lëkure*
Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikulli *dorashka prej lëkure* do të porositet dhe do të prodhohet në masat S–M–L–XL për femrat dhe S–M–L–XL për meshkujt dhe sasitë që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Për femra			
16–17.5 cm	18–20.5 cm	21–22 cm	22.5–23.5 cm
S	M	L	XL

Për meshkuj			
18.5–21 cm	21.5–23 cm	23.5–25.5 cm	26–28 cm
S	M	L	XL



A diagram of a right hand with fingers spread, positioned next to a vertical ruler. The ruler has markings from 18 to 27 cm. The hand's width is approximately 18 cm, and the palm width is approximately 8 cm.

Perimetri i pëllëmbës duhet të matet në pjesën më të gjerë të saj, kur pëllëmba është e hapur. Matja duhet bërë tek të dyja duart dhe për bazë do të merret masa më e madhe.

3. NGJYRA REFERENCË

Dorashkat dhe elementët e tjerë duhet të kenë ngjyrë të zezë sipas spektrit CIELCH 17, 2.875, 65.882

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

***Kujdes!**Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.*

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *dorashka prej lëkure*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.

Prerja

Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim optimal të materialit. Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara. Dorashkat e një pale duhet të priten nga e njëjta lëkurë për të shmangur tonalitetet në ngjyrë. Dorashkat duhet të priten në mënyrë që të kenë elasticitetin e duhur gjatë përdorimit.

5. NDËRTIMI I DORASHKAVE

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të dorashkave

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Dorashka për femra

Dorashka për meshkuj

Dorashkat për femra dhe meshkuj janë njësoj në material dhe ngjyrë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë sipas gjinisë përkatëse.

Pjesët përbërëse të dorashkës:

- pjesa e kurrizit dhe e pëllëmbës
- gishti i madh
- shiritat mes gishtave
- astari prej pellushi

Dorashkat e dimrit duhet të jenë të zeza, prej lëkure dhe me pjesë shtesë mes gishtave.

Pjesët e qepura nuk duhet të jenë të tërhequra ose me rrudha.

Tek kurrizi i dorashkës duhet të qepen tre penca dekorative me fill prej pambuku të tipit *pearl*. Ekstremitetet e pencave duhet të jenë më afër njëra-tjetrës për nga drejtimi i kyçit dhe më larg njëra - tjetrës për nga drejtimi i gishtave.

Buza e lirë e qafës duhet të paloset nga brenda rreth 5 mm dhe të qepet me tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Dorashkat duhet të shtrëngohen tek qafat me llastik të qepur në brendësi.

Dorashkat duhet të jenë të veshura me astar prej pellushi me ngjyrë të zezë.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.

- Dorashkat duhet të jenë të qepura mirë dhe të duken të rregullta kur të vishen nga punonjësit e Policisë së Shtetit.
- Meshini quhet i cilësisë së parë kur ka të përpunueshme jo më pak se 80% të sipërfaqes kur është i pangjyrosur dhe 90% të sipërfaqes kur është i ngjyrosur.
- Tek meshini i ngjyrosur defektet lejohen deri në 20% të sipërfaqes. Tek lëkura e kurrizit (kruponi) defektet lejohen nga 5–10% të sipërfaqes.
- Meshini duhet të jetë:
 - o i butë,
 - o me tollë (brumë) të fortë dhe të plotë,
 - o i ngjeshur dhe kompakt,
 - o i shtrirë mirë në të gjithë sipërfaqen.
- Meshini duhet të ketë:
 - o rezistencë maksimale ndaj njollave, ujit dhe nxehtësisë,
 - o ngjyrosje uniforme dhe të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen,
 - o formë të rregullt.
- Lëkura nuk duhet të egërsohet mbas lagies dhe montimit.
- Meshini duhet t'i rezistojë tërheqjes dhe të mos çahet gjatë qepjes.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - o Tegelat e qepjes së dorashkave duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - o Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniforme, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - o Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - o Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e dorashkës duhet të jenë simetrikë.
- Lëkura e dorashkës duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e dorezave është $\pm 2\%$.
- Lëkura, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruar. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 17234-1:2015
 - b. EN ISO 17234 - 2:2011
 - c. EN ISO 4045 - 2018 (vlera limit e pH për lëkurët që kanë kontakt direkt dhe jo direkt me lëkurën është 3.5 - 7.5)
- Prodhuksi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Dorashkat duhet të pajisen me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në qendër të qafës së dorashkës.

Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njërën anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes ndërsa në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit, masa dhe gjinia.

Në momentin e dorëzimit dorashkat duhet të jenë të pastra, të palosur dhe pa njolla.

Dorashkat e palosura një e majtë dhe një e djathtë duhet të futet në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen dorashka të së njëjtës masë dhe gjini. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë dorashkash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e dorashkave, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjitës (natriban).

**ANEKS - LISTA E TESTIMEVE QË DUHET TË SHOQËROJNË OFERTËN TEKNIKE
TË KËTIJ ARTIKULLI DHE REFERENCAT PËR METODAT E KRYERJES SË KËTYRE
TESTIMEVE**

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja	EN ISO 17131:2012 Lëkurë - Identifikimi i lëkurës me mikroskop.
Trashësia	EN ISO 2589:2016 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike - Përcaktimi i trashësisë.
Pesha	EN ISO 2420: 2017 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike- Përcaktimi i densitetit të dukshëm dhe masa për njësi të sipërfaqes.
Regjia	EN ISO 17075-2017 Lëkurë - Përcaktimet kimike të përmbajtjes së kromit (VI) në lëkurë.
Lagështira	EN ISO 4684 :2005 Lëkurë - Përcaktimi i lëndë avulluese (volatile)
Hiri	EN ISO 4047:2002 Lëkurë - Përcaktimi i mbetjeve sulfate totale dhe i mbetjeve sulfate të patretshme në ujë.
Yndyra	EN ISO 4048:2008 Lëkurë - Provat kimike - Përcaktimi i lëndës së tretur në diklormetan dhe përmbajtja e acideve yndyrorë të lirë.
Prania e oksidit të kromit	EN ISO 5398-1:2007 Lëkurë - Përcaktimi kimik i përmbajtjes së oksidit të kromit.
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	EN ISO 15700: 1998 Lëkurë - Testet e qëndrueshmërisë së ngjyrës -Qëndrueshmëria e ngjyrës në spërkatjen me ujë.
	EN ISO 11641: 2012 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në djersitje.
	EN ISO 11640: 2013 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në ciklet e fërkimit para-mbrapa.
	EN ISO 11642: 2012 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërisë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në ujë.
	EN ISO 11643: 2009 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës së mostrave të vogla në solucionet e pastrimit të thatë.
Rezistenca ndaj këputjes	EN ISO 3376: 2011 Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i forcës në tërheqje dhe i përqindjes së zgjatimit.
Zgjatja me ngarkesë	

Rezistenca ndaj plasjes së faqes	EN ISO 3378: 2006 Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në grisjen e bërë thërmia dhe indeksi i grisjes në thërmia.
pH	EN ISO 4045 - 2018
Azo ngjyrues	EN ISO 17234-1:2015 EN ISO 17234 - 2:2011


*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Jelek operacional multifunksional

1. MATERIALET

a. Materialet bazë që do të përdoren për prodhimin e artikullit *jelek operacional multifunksional* duhet të jenë të cilësisë së parë, të përshtatshme për veshje operationale, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	e zezë spektri sipas CIELCH 17, 2.875, 65.882	
Përbërja	100% poliamid	
Thurja 1	trikotazh rrejtë	
Thurja 2	diagonale	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4-5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Ngarkesa (forca) në grisje	drejtim gjatësor 840 kg/PA	drejtim transversal 700 kg/PA
Zgjatimi në tërheqje	140%	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5	
AZO Ngjyrues	Nuk duhet të jenë pranishëm	
pH	4.0 - 9	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme* - nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* - nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* - nota 6: *shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë të zezë do të fërkohet për një kohë të

caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e zezë nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elemente *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *jelek operacional multifunksional* duhet të jenë të cilësisë së parë dhe të përshtatshme për veshje operationale:

Fileto		
Fileto në formë shiriti për profilimin e bordeve të jelekut dhe xhepave. 	Ngjyra	E zezë
	Gjerësia	2 cm (1 cm e qepur)
Velcro		
Element <i>Velcro</i> femër/mashkull për hapjen/mbylljen e xhepave të jelekut dhe për vendosjen dhe zhvendosjen e xhepave në jelek. 	Përbërja	100% fibra poliamide
	Trashësia e dy elementëve të bashkuar	±3 mm
	Masa lineare	41 g/m ± 5%
	Ngjyra	njësoj si jeleku
	Trashësia e elementit <i>femër</i>	2.2 mm
	Trashësia e elementit <i>mashkull</i>	1.6 mm
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme	
	E ftohtë	- 30° C
	E nxehtë	pika e dobësimit 180° C
		pika e shkrirjes 210 – 250° C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës	
	Në larje	jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë	
	Në djersë	
	Në fërkim	

Perçina		
	d. 15 mm	
	Përbërja	tunxh (aliazh i zinkut dhe bakrit)
	Ngjyra	e zezë pa shkëlqim
Rripa shtrëngues		
	Përbërja	100% najlon
	Gjerësia	2.5 cm
	Ngjyra	e zezë
Zinxhirë		
Zinxhir për mbylljen e jelekut. 	Tipi	standard me hapje të poshtme
	Madhësia e dhëmbëzave	8 VS ose 10VF
	Përbërja e tekstilit	100% poliestër
	Dhëmbëzat	100% acetal
	Ngjyra	e zezë
Zinxhir për xhepat e brendshëm të jelekut. 	Tipi	standard, i mbyllur nga njëra anë.
	Madhësia e dhëmbëzave	4 CF ose 5 CF
	Përbërja e tekstilit	100% poliestër
	Dhëmbëzat	monofilament 100% poliestër
	Ngjyra	e zezë
Aksesorë të tjerë		
Unaza për vrimat e xhepave 	Një copë për secilin xhep të karikatorëve.	
	Përbërja	100 % poliestër
	Ngjyra	e zezë
Mekanizëm për shtrëngimin e rripave. 	Përbërja	100 % acetal
	Ngjyra	e zezë

Unaza të tipit "D" 	Përbërja	hekur i trajtuar me agjent kundër ndryshkut
	Ngjyra	e zezë
Llastik 	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e zezë
	Gjerësia	4 cm
Tokëza në dy përmasa: Për këllëfin e pistoletës  Për rripin e jelekut 	Përbërja	100 % acetal
	Ngjyra	e zezë
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% najlon
	Numri metrik	75 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N.
	Ngjyra	e zezë
Tekstil		
Tekstil prej gome për jastëkun e qytës	Ngjyra	e zezë
	Përbërja	100% polivinil kloruri PVC
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese, masën, mirëmbajtjen dhe përbërjen.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

c. Stampa të artikullit *jelek operacional multifunksional*:

Stampime		
Stampa përpara 12 cm POLICIA 2.2 cm	Përmasat e stampës përpara	2.2 x 12 cm
Stampa mbrapa 22 cm POLICIA 4.3 cm	Përmasat e stampës mbrapa	4.3 x 22 cm

d. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *jelek operacional multifunksional*

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



Qese polietileni për paketimin e jelekut

Kuti kartoni për paketimin e 30 jelekëve

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikulli *jelek operacional multifunksional* do të porositet dhe do të prodhohet në 3 masa standarde:

I	II	III
XS - L	XL - XXL	XXXL +

Jeleku do të prodhohet në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:




Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskulit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.	12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
16	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
	Gjatësia e supit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
			19	Gjatësia e supit	cm.
			25	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.

3. NGJYRAT REFERENCE

Ngjyra e zezë për tekstilin e jelekut, tekstilin rrjetë dhe aksesorët sipas spektrit CIELCH 17,2.875, 65.882

Ngjyra e bardhë për stampat në jelek sipas spektrit CIELCH 96, 2.573, 117.861

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit jelek operacional multifunksional.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përberëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhueshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 60 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përberëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha pjesët e artikullit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

5. NDËRTIMI I JELEKUT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të jelekut operacional multifunksional.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.





Jeleku duhet të jetë i tipit operacional (*tactical*) standard për forcat e policisë në detyrë. Çdo pjesë përbërëse e jelekut duhet të jetë me ngjyrë të zezë.

Kujdes! Jeleku dhe të gjithë aksesorët e tij duhet të jenë të cilësisë së lartë, për përdorim të zgjatur nga forcat e policisë. Jeleku nuk duhet të ngatërrohet me jelekë të cilësisë më të ulët për sporte si "airsoft" dhe "paintball", të cilët kanë të njëjtën pamje dhe konfiguracion.

Pjesët përbërëse të jelekut operacional multifunksional:

- Tre pjesët e jelekut prej rrjete
- Një xhep me kapak për radion
- Tre xhepa me kapakë për karikatorë për pistoletë dhe mjete të tjera
- Një xhep multifunksional drejtkëndor për gjoksin
- Këllëf i lëvizshëm (vezme) për saçmet e pushkës teke
- Dy xhepa të përparmë për karikatorë për pushkë automatike
- Dy xhepa rezervë të lëvizshëm për karikatorë për pushkë automatike,
- Një këllëf i lëvizshëm për pistoletë me xhep për karikator të vogël
- Dy xhepa anësor për transportin e karikatorit ose mjeteve të ndryshme: elektrik dore, spraj për lëng lotsjellës, etj.
- Rrip operacional me xhepa multifunksional të lëvizshëm
- Rripa shtërngues

SKELETI PREJ RRJETE

Skeleti duhet të jetë me rrjetë të dendur prej najloni shumë rezistent për përdorim të zgjatur (heavy duty). Pjesët e përparme të skeletit duhet jenë të lira dhe duhet të lidhen me shpinën vetëm nëpërmjet mekanizmave shtrëngues në supe dhe tek ijët.

Buzët e pjesëve prej rrjete duhet të jenë të profiluara me fileto prej najloni.

Mekanizmat shtrëngues. Jelevu duhet të jetë i pajisur me dy gjuhëza me *velcro* dhe tre rripa shtrëngues në çdo anë të ijëve që shërbejnë për rregullimin e masës së jelevut.

Jastëku i qytës. Gjithë zona e klavikulës së djathtë duhet të jetë e pajisur me jastëk dhe e veshur me gomë ose material tjetër kundër rrëshqitjes dhe rezistent ndaj fërkimit. Jastëku shërben për mbështetjen e qytës gjatë qitjes me pushkë automatike ose snajper.



Zinxhiri. Mbyllja e jelevut duhet të bëhet me anë të zinxhirit me dhëmbë plastike me gjatësi rreth 36 cm. Zinxhiri duhet të jetë i cilësisë së lartë, të mbyllet komplet dhe të jetë i pajisur me mekanizëm që bllokon hapjen nga tërheqja.

Ylyku i shpëtimit. Në zonën midis shpatullave, pak poshtë buzës së jakës, duhet të jetë i qepur ylyku i shpëtimit, i cili shërben si dorezë për ta tërhequr mbajtësin e jelevut jashtë rrezikut në rast se ai/ajo plagoset ose është pa ndjenja.

Si ylyku i shpëtimit ashtu edhe qepja e tij në jelek duhet të kenë rezistencë të madhe.

Xhepat e brendshëm. Tek zona e abdomenit, brenda, jelevu duhet të jetë e pajisur me dy xhepa të mëdhenj prej rrjete me zinxhir për transportin e materialeve të ndryshme.



Aksesorë të tjerë. Jeleku duhet të jetë i pajisur me të gjithë elementë e nevojshëm për fiksimin e aksesorëve të jashtëm si: unaza metalike tek supet, rripat shtrëngues të pozicionuar përgjatë buzës së poshtme të jelekut që shërbejnë për fiksimin e rripit operacional, element *velcro* femër në shpinë për fiksimin e shkrimit POLICIA dhe sistemi modular me shirita (ALICE) për fiksimin e sistemit hidratues ose aksesorëve të tjerë.

XHEPI I RADIOS

Në anën e majtë të jelekut, në zonën e klavikulës duhet të jetë i pozicionuar xhepi me kapak për transportin e radios. Xhepi duhet të ketë madhësinë e përshtatshme për transportin e radiove të vogla që ka në përdorim *Policia e Shtetit*.

Mbyllja e kapakut duhet të bëhet me element *velcro*. Xhepi duhet të jetë gjithashtu i pajisur me vrimë për shkarkimin e ujit.

TRE XHEPAT E VEGJËL

Poshtë xhepit të radios duhet të jenë pozicionuar tre xhepat e vegjël për transportin e karikatorëve të vegjël për pistoletë ose mjeteve të tjera stërgjatëshe si biçak, spraj për lëng lotsjellës, elektrik dore, etj.

Xhepat duhet të kenë madhësinë e përshtatshme për transportin e karikatorëve të pistoletave që ka në përdorim *Policia e Shtetit*.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me elementë *velcro*.

Xhepi duhet të jetë gjithashtu i pajisur me vrimë për shkarkimin e ujit.

XHEPI MULTIFUNKSIONAL

Në anën e djathtë të gjoksit, përballë me xhepat e vegjël, duhet të jetë i pozicionuar xhepi i gjerë drejtkëndor multifunksional me kapak në formë portofoli që shërben për transportin e mjeteve të ndryshme si p.sh. prangat, celular, etj.

Kapaku i xhepit duhet të jetë i pajisur me element *velcro* femër që shërben për fiksimin e këllëfit të saçmeve për pushkë teke ose fiksimin e shkrimit POLICIA.

XHEPAT E MËDHENJ

Në zonën e abdomenit dhe tek ijët duhet të jenë të pozicionuar katër xhepat e mëdhenj me përmasa 9 x 19.5 x 8.5 cm secili (gjerësi x lartësi x thellësi) që shërbejnë për transportin e karikatorëve për pushkë automatike AR 70/90, M4, M16, Ak 47.

Dy xhepa të mëdhenj duhet të jenë të pozicionuar në anë e djathtë të abdomenit, ndërsa dy xhepat e tjerë duhet të jenë të pozicionuar tek ijët.

Xhepat duhet të kenë madhësinë e përshtatshme për transportin e karikatorëve të pushkëve automatike që ka në përdorim *Policia e Shtetit*.

Xhepat duhet të jenë të përforcuar me llastik për të penguar lëvizjen e lirë të objekteve gjatë lëvizjes.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me elementë *velcro* mashkull/femër.

Xhepi duhet të jetë gjithashtu i pajisur me vrimë për shkarkimin e ujit.



ÇIFTI I XHEPAVE REZERVË

Jeleku duhet të plotësohet gjithashtu me një çift xhepash të mëdhenj që mund të fiksohen me *velcro* në vend të këllëfit të pistoletës.

Xhepat rezervë duhet të kenë të njëjtat përmasa dhe karakteristika si xhepat e tjerë të mëdhenj.

SIPËRFAQE VELCRO

Në anën e majtë të zonës së abdomenit duhet të jetë një sipërfaqe katrore e veshur me element *velcro* femër. Ky element shërben për fiksimin e dy komponentëve: këllëfit të lëvizshëm të pistoletës ose vendosjen e çiftit të xhepave rezervë për karikatorë të mëdhenj.

Fiksimi i këllëfit duhet të bëhet edhe me anë të rripave shtrëngues me tokëza plastike, të cilat duhet të jenë të qepura si tek jeleku ashtu dhe tek këllëfi.

KËLLËFI I PISTOLETËS

Këllëfi duhet të jetë i tipit standard për jelek polifunksional, i pajisur me një xhep për një karikator të vogël shtesë pistolette, element *velcro* mashkull dhe rripa shtrëngues me tokëza plastike për t'u fiksuar në jelek.

Këllëfi duhet të jetë relativisht i fortë dhe rezistent ndaj përdorimit të shpeshtë.

RRIPI OPERACIONAL

Jeleku duhet të shoqërohet bashkë me një rrip operacional dhe dy xhepa të lëvizshëm. Rripi duhet të fiksohet me anë të pesë rripave shtrëngues, të montuar në fund të jelekut.

Rripi duhet të jetë prej najloni, ndërsa tokëza e rripit duhet të jetë prej materiali plastik të cilësisë së lartë.

STAMPA “POLICIA”, PËRPARA DHE MBRAPA

Mbi kapakun e xhepit multifunksional, dhe mbrapa, në shpinë duhet të vendosen elementët *velcro* me fjalën *POLICIA* të stampuar. Stampimi duhet të bëhet mbi copa drejtkëndore tekstili prej najloni të njëjtë me xhepat, të pajisur me elementë *velcro* mashkull në anën e pasme. Copat drejtkëndore duhet të kenë përmasa që përputhen me elementët mbi të cilën do të vendosen.

Ngjyra e stampës duhet të jetë e bardhë. Gërmat e fjalës duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*. Fjala nuk duhet të shtrembërohet dhe deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i gërmës.

Përmasat e shkrimit përpara dhe mbrapa duhet të jenë sipas ilustrimit teknik.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së jelekut duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, dhe simetrikë, dhe nuk duhet të kenë shqepje ose difekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e jelekut duhet të jenë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional të tekstileve bazë (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, etj.)
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimeve tek përmasat e jelekut është $\pm 2\%$.

- Velcro-të, nuk duhet t'u dalin fije përgjatë anëve të lira të shiritit si në *Velcro* “mashkull” ashtu dhe në atë “femër” edhe pasi të jetë përsëritur disa herë montimi dhe çmontimi i dy pjesëve të saj.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Jelevu duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në qendër të jakës së jelevut, tek tegeli që bashkon fileton me pjesën e pasme të tij. Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njërin anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes dhe në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit dhe masa.

Në momentin e dorëzimit jelekët duhet të jenë të pastër, të palosur dhe pa njolla.

Jelevu i palosur duhet të futet në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen jelekë të së njëjtës prerje. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë jelekësh.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e jelevut, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura. EN ISO 8388:2005 Tekstilet -Pëlhurat e trikotuara.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle te larjes) EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit

	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni.
Ngarkesa në grisje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit
Zgjatimi në tërheqje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale.
AZO ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
pH	EN ISO 3071:2006
Procesi i trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TE DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Jelek shpëtimi

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *jelek shpëtimi* duhet të jetë i cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët dhe e zezë	
Përbërja %	100% poliamid	
Thurja	Oxford	
Masa lineare e fillit ($\pm 5\%$)	200 D	
Depërtueshmëria e ujit	mbi 20,000 mm	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 - 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 20000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5	
AZO ngjyruës	Nuk duhet të jenë pranishëm	
pH	4 - 9	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme* - nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* - nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* - nota 6: *shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu dhe të zezë do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu ose e zezë nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *jelek shpëtimi*:

Aksesorë		
Tokëz plastike për veshje taktike. 	3 copë	
	Përbërja	100 % PVC
	Ngjyra	gri
Rrip 	Gjerësia	3.5 – 4 cm
	Përbërja	100 % nylon
	Ngjyra	e zezë
Fibra pluskuese		
	Përbërja e fibrave pluskuese (sfungjer)	100% Polietilen i zgjeruar (ePE) sipas normativave EN ISO 12402:2006
	Pluskueshmëria	≥ 7.5 kg
	Humbja e pluskueshmërisë	≤ 5% (brenda 24 orëve)
	Pluskueshmëria (forca e qëndrimit mbi ujë)	mbi 150 N
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja:	100% poliamid
	Numri:	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje:	jo më pak se 12N.
	Ngjyra	me të njëjtin tonalitet si tekstili i jeleku
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja:	100% Poliester
	Ngjyra:	e bardhë

c. Procese stampimi për artikullin *jelek shpëtimi*:

Stampime	
Shkrimi POLICIA, para dhe mbrapa	Përmasat e stampës para 11 x 2.2 cm
Stampa përpara 11 cm POLICIA 2.2 cm	Përmasat e stampës mbrapa 32 x 10.5 cm
Stampa mbrapa 35 cm POLICIA 10.5 cm	Stampim me bojë të bardhë.
	Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Gërmat e fjalës duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë <i>Myriad Pro Bold</i> .

d. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *jelek shpëtimi*.

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikulli *jelek shpëtimi* do të prodhohet në masat dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Masa duhet të përcaktohet sipas peshës trupore dhe perimetrit të krahavorit.

Masa	S	M	L	XL	XXL
Pesha në kg	40–50	50–70	70–80	80–90	90+
Perimetri i krahavorit	80–90	90–100	100–110	110–120	120–130

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.
16	Lartësia perpara nga supi në vijën e belit	cm.
	Gjatësia e supit	cm.
	Pesha trupore	kg.

3. NGJYRAT REFERENCË



Tekstili i jelekut nga jashtë duhet të ketë ngjyrë blu të errët. Sipas spektrit CIELCH 21, 25.736, 288.603

Tekstili i jelekut në brendësi duhet të ketë ngjyrë të zezë. Sipas spektrit CIELCH 17, 2.875, 65.882

Shkrimi POLICIA duhet të jetë me ngjyrë të bardhë. Sipas spektrit CIELCH 96, 2.573, 117.861

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *jelek shpëtimi*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përberëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhueshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përberëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e artikullit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

5. NDËRTIMI I JELEKUT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të jelekut

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Jeleku i shpëtimit duhet të jetë Tip III universal që pluskon. Funkzioni i jelekut Tip III është që të përdoret nga forcat e policisë me shërbim në anije ose motoskafe.

Pjesët përbërëse të jelekut:

- Tekstili i padepërtueshëm nga uji
- Materiali pluskues
- Rripat shtrëngues

Jeleku duhet të jetë nga jashtë me tekstil me ngjyrë blu të errët dhe nga brenda tekstil me ngjyrë të zezë. Tekstilit duhet të jetë prej najloni të padepërtueshëm nga uji.

Jeleku duhet të jetë i mbushur me sfungjer pluskues prej polietileni.

Mbyllja e jelekut duhet të bëhet në pjesën e abdomenit dhe gjoksit me anë të rripave prej najloni shumë të fortë, të pajisur me tokëza plastike, që vijnë rreth përfaqjelekut. Tek ijet jeleku duhet të me pjesë të veçuara.

Rripat shtrëngues duhet të fiksohen mirë tek tekstili i jelekut me ylykë najloni, në pjesën e përparme dhe të pasme, në mënyrë që të mos rrëshqasin.

SHKRIMI POLICIA, PËRPARA DHE MBRAPA

Në pjesën e përparme dhe të pasme të jelekut, duhet të stampohet fjala *POLICIA*. Stampa duhet të jetë e bardhë. Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik të mëposhtëm. Gërmat e fjalës duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*. Fjala nuk duhet të shtrembërohet ose deformohet horizontalisht dhe vertikalisht. Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Ai nuk duhet të fshihet apo të humbasë efektin identifikues gjatë përdorimit.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Jeleku duhet të përmbushë standardin ndërkombëtar EN ISO 12402-3
- Të gjitha tekstilet dhe materialet e jelekut duhet të kenë rezistencë maksimale ndaj flakës.
- Jeleku duhet të ketë pluskueshmëri (forca e qëndrimit mbi ujë) mbi 150N
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.

- Tegelat e qepjes së jelekut duhet të jenë me hap 5 shpime në 1 cm.
- Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, dhe simetrikë, dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
- Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
- Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e jelekut duhet të jenë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, stampimit, etj.)
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë veti hidrofobike.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Jeleku duhet të pajiset me etiketë prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Gjithashtu secili jelek shpëtimi do të shoqërohet dhe me një broshurë informative me karakteristikat teknike të produktit dhe për mënyrën e duhur të përdorimit të tij.

Etiketa duhet të qepet në brendësi të jelekut, poshtë në anën e djathtë të tij. Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njërin anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes dhe në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit dhe masa/pesha.

Në momentin e dorëzimit jelekët duhet të jenë të pastër, të rregullt dhe pa njolla.

Jeleku duhet të futet në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen jelekë të së njëjtës masë/peshë. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë jelekësh.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë adezive, në të cilën duhet shënuar masa e jelekut, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve ISO*
Jeleku duhet të përmbushë standardin ndërkombëtar EN ISO 12402-3	
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03:

	Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Hollësia e fije	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Depërtueshmëria e ujit	EN 20811/ ISO 811:2018 Tekstilet. Përcaktimi i rezistencës ndaj depërtimit të ujit.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni.
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale.
Fibra pluskuese	Në përputhje me normativën: EN ISO 12402:2006
Azo Ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Jelek prezantues

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *jelek prezantues operacional* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët (evening blue) spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349			
Përbërja % (±5%)	65% Poliester		35 % Pambuk	
Thurja	Diagonale (gabardine)			
Masa gr/m² (±5%)	210gr/m²			
Dendësia/10mm ±2	baza	37/10 mm	indi	24/10 mm
Hollësia e fijes (±5%)	baza	20/1 Nm	indi	20/1 Nm
Qëndrueshmëria në N	baza	≥ 1200 N	indi	≥ 700 N
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4 - 5 (Shkalla gri)		Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)		Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 10,000 cikle			
Efekti pilling (kokërrzimi)	Nota 4 – 5			
AZO ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem			
pH	4.- 9			

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se - nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *jelek prezantues*.

Fileto			
Fileto me prerje diagonale, për profilimin e bordurave të jelekut.	Përbërje	100% poliester	
	Ngjyra	me të njëjtën ngjyrë si jeleku	
	Gjerësia	1 cm (e qepur 0.5 cm)	
Velcro			
Elementë <i>Velcro</i> femër - mashkull për mbylljen e jelekut. 	Përbërja	100% fibra poliamide	
	Trashësia	2.2 mm	
	Masa lineare	41 g/m ± 5%	
	Ngjyra	njësoj si tekstili	
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë	- 30 °C	
	E nxehtë	pika e dobësimit	180 °C
		pika e shkrirjes	210 – 250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje	jo më pak se 3	
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
	Në fërkim		
Llastik			
Shirit llastiku për mbylljen e jelekut. 	Gjerësia:	2.5 cm	
	Ngjyra:	E zezë	
Filli			
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja:	100% poliester	
	Numri:	80 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje:	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	me të njëjtin tonalitet si tekstili i jelekut	

Etiketat		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja:	100% Poliester
	Ngjyra:	e bardhë

c. Procese stampimi për artikullin *jelek prezantues*

Stampime	
Shkrimi POLICIA, para 	Përmasat e stampës para 11 x 2.2 cm
Shkrimi POLICIA, mbrapa 	Përmasat e stampës mbrapa 32 x 10.5 cm Stampim me bojë të bardhë. Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Gërmat e fjalës duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë <i>Myriad Pro Bold</i> .

d. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *jelek prezantues*:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.

	
1 qese polietileni për paketimin e një jeleku	
1 kuti kartoni për paketimin e 50 jelekëve	

Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikulli *jelek prezantues operacional* do të porositet dhe do të prodhohet në dy masa standarde. Jeleku duhet të jetë i llojit *unisex*.

Masa I	Masa II
XS - S - M - L	XL - XXL - 4XL

Jeleku do të prodhohet në masat dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:




3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.
16	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
	Gjatësia e supit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCE

Ngjyra blu për tekstin e jelekut. Sipas spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349

Ngjyra e bardhë për stampat në jelek. Sipas spektrit CIELCH 96, 2.573, 117.861.

Ngjyrat e paraqitur në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampionëve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit jelek prezantues operacional.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhueshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonalitete të dukshme.

5. NDËRTIMI I JELEKUT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të jelekut.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.





Jeleku prezantues operacional duhet të qepet me dy pjesë, në formën e grykësës që vishet nga koka. Pjesa e pasme dhe e përparme duhet të jenë të bashkuara vetëm tek supet.

Jeleku duhet të jetë i profiluar nga të gjithë anët me një fileto me ngjyrë blu të errët me gjerësi rreth 5 mm.

Jeleku duhet të pajiset me dy llastikë me elementë *velcro* mashkull/femër tek ijët që shërbejnë për shtrëngimin dhe fiksimin e dy pjesëve të jelekut.

Jeleku duhet ti ketë këndet e poshtëme të harkuara.

Në pjesën e përparme, tek gjoksi, dhe mbrapa në shpinë, duhet të stampohet shkrimi POLICIA me ngjyrë të bardhë.

SHKRIMI “POLICIA”, PËRPARA



Në pjesën e përparme të jelekut, në anën e djathtë të gjoksit, duhet të stampohet fjala POLICIA. Pozicionimi dhe përmasa e stampës duhet të bëhet sipas ilustrimit teknik.

Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Gërmat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt dhe uniforme. Gjatë përdorimit stampa nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

SHKRIMI “POLICIA”, MBRAPA



Në pjesën e pasme të jelekut, në shpinë, duhet të vendoset shkrimi POLICIA. Shkrimi duhet të jetë i vendosur në një distancë rreth 10 cm poshtë harkut të jakës.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt dhe uniforme. Gjatë përdorimit stampa nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së jelekut duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrikë dhe nuk duhet të kenë shqepje ose difekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e jelekut duhet të jenë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Jelekët duhet të jenë të lehtë për tu mirëmbajtur.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikaten e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Jeleku duhet të pajiset me etiketë prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në qendër të jakës së jelekut, tek tegeli që bashkon fileton me pjesën e pasme të tij. Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njëërën anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes dhe në anën tjetër duhet të shënohet: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit dhe masa.

Në momentin e dorëzimit jelekët duhet të jenë të pastër, të hekurosur, të palosur dhe pa njolla.

Jeleku i palosur duhet të futet në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen jelekë të së njëjtës prerje. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë jelekësh.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e jelekut, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Hollësia e fijos	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Qëndrueshmëria në N	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit

	EN ISO 105-E04 : 2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TE DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Rrip për uniformën ceremoniale

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *rripi i uniformës ceremoniale* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Përbërja	lëkurë e plotë viçi (telatinë), shtresa e parë
Ngjyra	e bardhë, e njëtrajtshme, me pak shkëlqim
Trashësia	4 mm
Regjja	gjysmë kromike
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	Nota 4-5
Trajtimi	kundër ujit
Lagështira	jo më shumë se 18%
Hiri	jo më shumë se 3.4%
Yndyra	8–15%
Lëndë larëse	jo më shumë se 6%
Lëndë lëkurë	37-46%
Koeficienti i regjjes	jo më pak se 55%
Prova e regjjes	Pozitive
Prova e mos regjjes në prerje	Negative
Zgjatimi deri në këputje	35%
Zgjatja me ngarkesë per 10 Mpa	jo më pak se 25
Rezistenca ndaj plasjes së faqes per 10 MPa	jo më pak se 2
Fortësia në këputje per 10 MPa	jo më pak se 2.5
AZO ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem
pH	3.5-7.5

Kërkesat e lëndës së parë për lëkurë natyrale, (telatinë), janë bazuar tek Standardi Shqiptar (SSH) 1145: 1990, "Telatinë".

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim.


Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i lëkurës, do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e bardhë e lëkurës nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e materialeve, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- prerja nga ana e mishit që nuk kalon 1/3 e trashësisë,
- gërvishtje mbi faqe,

- dëmtime nga kalbja,
- plasje të faqes nga barazimi,
- plasje e faqes nga palosja katërshe,
- gjurmë damarësh,
- ngjyrim jo i njëlojtë,
- njolla yndyre, kromi ose ekstrakti,
- gërvishtje ose plagë të shëruara,
- pjesë të dobëta,
- vija majmërie ose rrudha të shtrira në trup e qafë,
- thellime nga rrahja,
- valëzime dhe gropëzime,
- pika ose vrima që vijnë si rezultat i pickimeve të insekteve kur kafsha është e gjallë,
- rrudha nga palosjet në kavaletë,
- shkallëzime nga barazimi
- hollime nga sharrimi,
- oksidime,
- porozitet,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të dorashkës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit rrip për uniformën ceremoniale duhet të jenë të cilësisë së parë:

Tokëza			
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm	
	Përmasa	5.5 x 7.5 cm	
	Tipi	me 2 kunjë për fiksion	
	Ngjyra	e artë, me shkëlqim	
	Montimi	Me dy kunjë mbrapa	
	Skalitje	Stema e Policisë së Shtetit	
		Përmasa	4 x 4.6 cm
Ngjyra		e artë, me shkëlqim	
Perçina metalike			
	Diametër	9 mm	
	Ngjyra	e artë, me shkëlqim	
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)	
Filli			
Fill qepës për qepjen e ylykut	Përbërja	100% pambuk	
	Numri metrik	50 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	si rripi	

Tokëza metalike do ti nënshtrohet testimeve të mëposhtme:

- **Rezistencës ndaj ujit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion sapun larës 3% në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool metilik e më pas me benzinë.
- **Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në 1% klorur sodiumi në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje.** Nuk duhet të ketë ndryshime të ngjyrës pasi të jetë trajtuar me 5% solucion HCl.
- **Rezistenca ndaj korrozionit.**

Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element si p.sh: që materialet e përdorura janë të përshtatshme për produktin, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj. Kontrolli do të bëhet me sy të lirë dhe me mjete të caktuara.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë tokëza, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- kokërrzim (punime të ashpra),
- tonalitete të ngjyrës,
- ndryshim në dendësi të materialit,
- shkëputje të pjesëve,
- gropëzime ose plasaritje,
- relieve jo të rregullta,
- metalizim jo i rregullt dhe jo rezistent,
- oksidime,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit rrip për uniformën ceremoniale:

Letër e hollë për paketimin e një rripi.
Qese polietileni për paketimin e një rripi.
1 kuti kartoni për paketimin e 50 rripave ose më shumë.

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendeshen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.


2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli rrip i uniformës ceremoniale do të porositet dhe do të prodhohet në sasi të përkatëse në masat S - 4XL për meshkuj dhe për femra të cilat subjekti prodhues është i detyruar t'i respektojë saktësisht.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Perimetri i mesit (rripi vendoset mbi xhaketë)	cm
--	----



Nga togeza (A) deri në vrimën më të përdorshme të rripit (B).

Masa e rripit						
S	M	L	XL	XXL	XXL	4XL
71-76 cm	81-86 cm	91-96 cm	101-106 cm	111-116 cm	121-127 cm	132-137 cm

3 NGJYRAT REFERENCË

Ngjyra e bardhë është për lëkurën e rripit sipas spektrit CIELCH 96, 2.573, 117.861

Ngjyra e artë është për të gjitha pjesët metalike të rripit sipas spektrit CIELCH 72, 63.619, 74.057

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit rrip për uniformën ceremoniale.


Prerja

Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim optimal të materialit. Rripit duhet të përbëhet nga një pjesë e vetme (pa bashkime). Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara. Rripit duhet të priten në mënyrë që të kenë elasticitetin e duhur gjatë përdorimit.

5. NDËRTIMI TEKNIK I RRIPI

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të rripit për uniformën ceremoniale

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Ripi ceremonial duhet të jenë prej lëkure dhie me ngjyrë të bardhë.

Pjesët përbërëse të rripit:

- Lëkura
- Tokëz drejtkëndore me dy kunjë
- Ylyku

LËKURA

Lëkura duhet të jetë 5 cm e gjerë për të dyja gjinitë. Nga ana e jashtme ajo duhet të jetë me shkëlqim, ndërsa në anën e brendshme duhet të stampohet emri i fabrikës prodhuese dhe masa e rripit.

Ripi duhet të ketë 10 çifte vrimash me diametër 10 mm dhe distancë 25 mm larg njëri-tjetri.

Maja e rripit duhet të jetë gjysmë e rrumbullakosur.

Lëkura duhet të përshkohet nga një tegel perimetral linear një gjilpërësh fals me distancë 3 mm nga buza, për funksion estetik. Tegeli duhet të realizohet nëpërmjet stampimit me të nxehtë në sipërfaqe.

TOKËZA



Tokëza duhet të jetë në formë pllake drejtëkëndore me dy kunjat të pozicionuara në aks vertikal në njërin skaj të tokëzës dhe një unazë metalike në skajin tjetër, atje ku fiksohet rripi. Distanca mes kunjave duhet të korrespondojë me distancën mes vrimave të rripit. Forma e tokëzës duhet të jetë e njëjtë për të dyja gjinitë. (Materiali i tokëzës dhe përmasat figurojnë tek tabela e materialeve)

Fiksimi i tokëzës tek rripi duhet të bëhet nëpërmjet lëkurës së palosur e të bashkuar me perçinë metalike. Në qendër të pllakës së tokëzës duhet të jetë e gdhendur me bazoreliev stema e Policisë së Shtetit.

YLYKËT

Rripi duhet të pajiset me një ylyk për fiksimin e majës së rripit. Ai duhet të jenë ndërtuar me të njëjtin material si lëkura e rripit.

Ylyku duhet të jenë rreth 14 mm i gjerë. Trashësia e lëkurës duhet të jetë 3 mm. Ylyku duhet të jetë i lirë.

Përmasa të pandryshueshme të rripit	
Gjerësia	5 cm
Trashësia	4 mm

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Pjesët e rripit që do të jenë në kontakt me lëkurën nuk duhet ta gërvishtin, acarojnë ose dëmtojnë atë.
- Kufiri i lejuar i gabimit është 1–1.5 cm tek gjatësia dhe ± 1 mm tek gjerësia.
- Lëkura e rripit duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Lëkura duhet të ketë këto kërkesa cilësore:
 - Duhet të jetë regjur mirë në të gjithë sipërfaqen.
 - Faqja e jashtme duhet të jetë e pastër, e lëmuar dhe pa njolla.
 - Ngjyrosja duhet të jetë uniforme në të gjithë sipërfaqen.
 - Faqja e brendshme duhet të jetë e pastruar nga mbeturina e skanimit.
 - Përkulshmëria e lëkurës duhet të jetë e lartë.
 - Duhet të jetë e vajosur mirë.
 - Duhet të jetë e ngjeshur.
 - Duhet të ketë trashësi të barabartë në të gjithë sipërfaqen.
 - Duhet të jetë kompakte.
 - Lustra duhet të jetë e fiksuar mirë.
- Togëza nuk duhet të lerë shenja tek materialet me të cilat do të bien në kontakt.
- Lëkura, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruar. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 17234-1:2015
 - b. EN ISO 17234 - 2:2011
 - c. EN ISO 4045 - 2018 (vlera limit e pH për lëkurët që kanë kontakt direkt dhe jo direkt me lëkurën është 3.5 - 7.5)
- Prodhuuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Rripat duhet të mbështillen me letër të hollë. Rripi i mbështjellë me letër duhet të futet në një qese polietileni i rrotulluar në vetvete.

Qeset me rripa të së njëjtës masë do të futen në një kuti kartoni me nga 50 rripa secila.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e rripit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjithës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja	EN ISO 17131:2012 Lëkurë - Identifikimi i lëkurës me mikroskop.
Trashësia	EN ISO 2589:2016 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike - Përcaktimi i trashësisë.
Pesha	EN ISO 2420: 2017 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike- Përcaktimi i densitetit të dukshëm dhe masa për njësi të sipërfaqes.
Regjia	EN ISO 17075-2017 Lëkurë - Përcaktimet kimike të përmbajtjes së kromit (VI) në lëkurë.
Lagështira	EN ISO 4684 :2005 Lëkurë - Përcaktimi i lëndë avulluese (volatile)
Hiri	EN ISO 4047:2002 Lëkurë - Përcaktimi i mbetjeve sulfate totale dhe i mbetjeve sulfate të patretshme në ujë.
Yndyra	EN ISO 4048:2008 Lëkurë - Provat kimike - Përcaktimi i lëndës së tretur në diklormetan dhe përmbajtja e acideve yndyrorë të lirë.
Prania e oksidit të kromit	EN ISO 5398-1:2007 Lëkurë - Përcaktimi kimik i përmbajtjes së oksidit të kromit.
Lëndë larëse	EN ISO 4044:2017 Lëkurë - Provat kimike - Përgatitja e mostrave për provat kimike.
Lëndë lëkurë	
Koeficienti i regjjes	
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	EN ISO 15700: 1998 Lëkurë - Testet e qëndrueshmërisë së ngjyrës -Qëndrueshmëria e ngjyrës në spërkatjen me ujë.
	EN ISO 11640: 2013 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në ciklet e fërkimit para-mbrapa.
	EN ISO 11642: 2012 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërisë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në ujë.
Zgjatimi deri në këputje	EN ISO 3376: 2011 Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i forcës në tërheqje dhe i përqindjes së zgjatimit.
Fortesia në këputje	
Zgjatja me ngarkese	

Rezistenca ndaj plasjes së faqes	EN ISO 3378: 2006 Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në grisjen e bërë thërmia dhe indeksi i grisjes në thërmia.
pH	EN ISO 4045 - 2018
Azo ngjyrues	EN ISO 17234-1:2015 EN ISO 17234 - 2:2011


*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Rripi operacional multifunksional

1. MATERIALET

a. Materialet bazë që do të përdoren për prodhimin e artikullit *rripi operacional multifunksional* duhet të jenë të cilësisë së parë, të përshtatshme për funksione operationale, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	E zezë spektri sipas CIELCH 17,2.875, 65.882	
Përbërja %	100% poliamid	
Masa lineare e fillit	850-950 D	
Thurja e tekstilit të rripit	Oxford	
Thurja e tekstilit të aksesorëve të rripit	Garniturë	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Ngarkesa (forca) në grisje	Baza = 840 KG/PA	Indi = 700 kG/PA
Zgjatueshmëria në tërheqje në drejtim horizontal dhe vertikal:	140%	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 20000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5	
AZO ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4 - 9	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se - nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë të zezë do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e zezë nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,

- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të artikullit.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *rripi operacional multifunksional* duhet të jenë të cilësisë së parë dhe të përshtatshme për funksione operacionale:

Velcro		
Element <i>Velcro</i> femër/mashkull. 	Përbërja	100% fibra poliamide
	Trashësia e dy elementëve të bashkuar	± 3 mm
	Masa lineare	41 g/m ± 3%
	Ngjyra	njësoj si jeleku
	Trashësia, elementi <i>femër</i>	2.2 mm
	Trashësia, elementi <i>mashkull</i>	1.6 mm
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme	
E ftohtë	- 30° C	
E nxehtë	pika e dobësimit	180° C
	pika e shkrirjes	210 – 250° C
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Në larje	jo më pak se 3	
Në ujë të nxehtë		
Në djesë		
Në fërkim		
Aksesorë të ndryshëm		
Rrina për vlvkët e këllëfëve. 	Trashësia	3 mm
	Përbërja	100% najlon
	Ngjyra	e zezë
Tokëza plastike për mbylljen e rripit. 	Përbërja	100% acetal
	Ngjyra	e zezë
Perçina. 	d. 15 mm	
	Përbërja	tunxh (aliazh i zinkut dhe bakrit)

	Ngjyra	e zezë pa shkëlqim
Fileto		
Fileto për profilimin e buzëve të jelekut dhe xhepave. 	Ngjyra	e zezë
	Gjerësia	2 cm (1 cm e qepur)
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si rripi
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese, masën, mirëmbajtjen dhe përbërjen.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e zezë

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *rrip operacional multifunksional*

Qese polietileni për paketimin e një rripi
Kuti kartoni për paketimin e 50 rripave

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuar.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *rrip operacional multifunksional* do të porositet dhe do të prodhohet në 4 masa:

Masat e rripit				
	I	II	III	IV
Gjatësia minimale	70	80	100	110
Gjatësia maksimale	95	105	120	137

Rripi do të prodhohet në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Perimetri i belit	cm
-------------------	----

3. NGJYRA REFERENCE

Ngjyra e zezë për rripin dhe për tekstin e aksesorëve të rripit Sipas spektrit CIELCH 17, 2.875, 65.882.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.



4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit rripi operacional multifunksional .

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përberëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhueshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e artikullit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonalitete të dukshme.

5. NDËRTIMI TEKNIK I RRIPI

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të rripit multifunksional.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Rripi



Rripi me aksesoret e montuar

Rripi duhet të jetë i tipit operacional (*tactical*) standard, i pajisur me të gjithë aksesoret e nevojshëm për forcat e policisë në detyrë.

Pjesët përbërëse të rripit:

- Rripi
- Tokëza plastike
- Ylykët

Aksesorët e rripit:

- Këllëf për pistoletën
- Xhepi i dyfishtë me kapak për karikatorët e pistoletës
- Unaza metalike për shkopin të gomës ose elektrikun e dorës
- Xhepi me kapak për gypin e alkoolit
- Xhepi me kapak për prangat
- Xhepi me kapak për spraj me lëng lotsjellës
- Xhepi me kapak për radion
- Xhepi për teleskopin ose detektorin e metaleve
- Mbajtëse çelësash
- Xhepi për dorashkat prej lateksi

Ripi duhet të ketë mekanizëm shtrëngues për përshtatjen sipas masës së përdoruesit.

Ripi duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj përdorimit të zgjatur, grisjes, abrazionit, etj.

Ripit duhet të mbyllet me anë të tokëzës plastike.

Xhepat duhet të mbyllen me perçina metalike.

Xhepat duhet të jenë të pajisur në pjesën e pasme me ylykë në mënyrë që të vendosen e hiqen sipas dëshirës.

Përmasat të pandryshueshme	
Gjerësia	6 cm
Trashësia	3 – 4 mm



Aksesorët e rripit	
Xhepi i dyfishtë me kapak për karikatorët e pistoletës.	
Unaza metalike për shkopin të gomës ose elektrikun e dorës.	

Xhep me kapak për gypin e alkoolit.	
Xhep me kapak për prangat.	
Xhep me kapak për spraj me lëng lotsjellës.	
Xhep me kapak për radion.	
Xhep për teleskopin ose detektorin e metaleve.	

Këllëf për pistoletën.	
Mbajtëse çelësash.	
Xhep për dorashkat prej lateksi.	

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, dhe simetrikë, dhe nuk duhet të kenë shqepje ose difekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e rripit dhe aksesorëve duhet të jenë simetrikë. (si lartësia dhe trashësia, gjatësia e rripit, togëza, kaluesit etj).
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, etj.)

- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e rripit është $\pm 2\%$.
- Velcro-të, nuk duhet t'u dalin fije përgjatë anëve të lira të shiritit si në Velcro "mashkull" ashtu dhe në atë "femër" edhe pasi të jetë përsëritur disa herë montimi dhe ç'montimi i dy pjesëve të saj.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:
 - EN ISO 14362-1:2017
 - EN ISO 14362-3:2017
 - EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Pjesët e rripit që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me punonjësin nuk duhet të jenë të ashpra, të kenë tehe të mprehta, ose projeksione që mund të shkaktojnë iritime të lëkurës apo dëmtime.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me çertifikaten e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Rripat bashkë me aksesoret e tyre duhet të futen në një qese polietileni.

Qeset me rripa duhet të futen në një kuti kartoni me 50 rripa secila. Në çdo kuti duhet të vendosen rripa të së njëjtës masë dhe çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë rripash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e rripit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjites (natriban).

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa lineare e fillit	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.

Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 : 2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Ngarkesa në grisje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit
Zgjatimi në tërheqje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TE DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Rripi i pantallonave

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikujve rripi i pantallonave të uniformës duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Përbërja	lëkurë e plotë viçi (telatinë), shtresa e parë
Ngjyra	e zezë, e njëtrajtshme, me pak shkëlqim
Trashësia	4 mm
Regjja	gjysmë kromike
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	Nota 4-5
Trajtimi	kundër ujit
Lagështira	jo më shumë se 18%
Hiri	jo më shumë se 3.4%
Yndyra	8-15%
Lëndë larëse	jo më shumë se 6%
Lëndë lëkurë	37-46%
Koeficienti i regjjes	jo më pak se 55%
Prova e regjjes	pozitive
Prova e mos regjjes në prerje	negative
Zgjatimi deri në këputje	35%
Zgjatja me ngarkesë për 10Mpa	jo më pak se 25
Rezistenca ndaj plasjes së faqes për 10Mpa	jo më pak se 2
Fortësia në këputje për 10Mpa	jo më pak se 2.5
AZO ngjyrues	Nuk duhet të jete te pranishem
pH	3.5-7.5

Kërkesat e lëndës së parë për lëkurë natyrale, (telatinë), janë bazuar tek Standardi Shqiptar (SSH) 1145: 1990, "Telatinë".

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i lëkurës, do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e zezë e lëkurës nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e materialeve, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- prerja nga ana e mishit që nuk kalon 1/3 e trashësisë,
- gërvishtje mbi faqe,

- dëmtime nga kalbja,
- plasje të faqes nga barazimi,
- plasje e faqes nga palosja katërshe,
- gjurmë damarësh,
- ngjyrim jo i njëlojtë,
- njolla yndyre, kromi ose ekstrakti,
- gërvishtje ose plagë të shëruara,
- pjesë të dobëta,
- vija majmërie ose rrudha të shtrira në trup e qafë,
- thellime nga rrahja,
- valëzime dhe gropëzime,
- pika ose vrima që vijnë si rezultat i pickimeve të insekteve kur kafsha është e gjallë,
- rrudha nga palosjet në kavaletë,
- shkallëzime nga barazimi
- hollime nga sharrimi,
- oksidime,
- porozitet,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të dorashkës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *rripi i pantallonave të uniformës* duhet të jenë të cilësisë së parë:

Tokëza		
	Përbërja	100% nikel
	Ngjyra	gri me pak shkëlqim
Perçina metalike		
	Përbërja	100% nikel
	Diametri	9 mm
	Ngjyra	gri me pak shkëlqim
Filli		
Fill qepës për qepjet e rripit.	Përbërja	100% pambuk
	Numri metrik	40 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	si rripi

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë tokëza, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- kokërrzim (punime të ashpra),
- tonalitete të ngjyrës,
- ndryshim në dendësi të materialit,
- shkëputje të pjesëve,
- gropëzime ose plasaritje,
- reliev jo të rregullta,
- metalizim jo i rregullt dhe jo rezistent,
- oksidime,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit rripi i pantallonave të uniformës:

Letër e hollë për paketimin e një rripi.
Qese polietileni për paketimin e një rripi.
1 kuti kartoni për paketimin e 50 rripave ose më shumë.

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikulli rripi i pantallonave të uniformës do të porositet dhe do të prodhohet në sasi të përkatëse në masat S - 4XL dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Perimetri i belit (linja ku mbahen pantallonat)	cm
---	----

Masa e rripit						
S	M	L	XL	XXL	XXL	4XL
71-76 cm	81-86 cm	91-96 cm	101-106 cm	111-116 cm	121-127 cm	132-137 cm



Nga togeza (A) deri në vrimën më të përdorshme të rripit (B).

3. NGJYRA REFERENCE

Rripi duhet të jetë me ngjyrë të zezë. Sipas spektrit CIELCH 17, 2.875, 65.882

Pjesët metalike duhet të jenë me ngjyrë gri me pak shkëlqim.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit rripi i pantallonave të uniformës.

Prerja

Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim optimal të materialit. Rripit duhet të përbëhet nga një pjesë e vetme (pa bashkime). Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara. Rripi duhet të priten në mënyrë që të kenë elasticitetin e duhur gjatë përdorimit.

5. NDËRTIMI TEKNIK I RRPIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të rripit të pantallonave të uniformës.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Rripit duhet të jetë prej lëkure viçi (telatinë) me ngjyrë të zezë.

Pjesët përbërëse të rripit:

- Lëkura
- Tokëz katrore me një kunj
- Ylykët


LËKURA

Lëkura duhet të jetë 3.5 cm e lartë tek meshkujt dhe 3 cm e lartë tek femrat. Nga ana e jashtme ajo duhet të jetë me shkëlqim, ndërsa në anën e brendshme duhet të stampohet emri i fabrikës prodhuese dhe masa e rripit.

Ripi duhet të ketë 7 vrima me diametër 10 mm dhe distancë 30 mm larg njëra-tjetrës.

Maja e rripit duhet t'i ketë kulmet e prera.

Lëkura duhet të përshkohet nga një tegel perimetral linear një gjilpërësh fals me distancë 3 mm nga buza, për funksion estetik. Tegeli duhet të realizohet nëpërmjet stampimit me të nxehtë në sipërfaqe.




Kujdes! Gjatësia e rripit varion sipas masës së tij.

TOKËZA

Forma e tokëzës duhet të jetë e njëjtë për të dyja gjinitë. Tokëzat e femrave duhet të jenë më të vogla.

Tokëza dhe kunja duhet të jenë prej nikeli me ngjyrë gri me shkëlqim.

Fiksimi i tokëzës tek rripi duhet të bëhet nëpërmjet lëkurës së palosur e të bashkuar me perçinë metalike.



YLYKËT

Rripi duhet të pajiset me dy vegë për fiksimin e fundit të rripit. Ato duhet të jenë ndërtuar me të njëjtin material si lëkura e rripit.

Ylykët duhet të jenë rreth 13 mm të gjerë. Trashësia e lëkurës duhet të jetë 3 mm.

Një nga ylykët duhet të montohet bashkë me tokëzën, ndërsa ylyku tjetër duhet të jetë i lirë.

Përmasa të pandryshueshme të rripit për femra	
Gjerësia	3 cm
Trashësia	4 mm
Përmasa të pandryshueshme të rripit për meshkuj	
Gjerësia	3.5 cm
Trashësia	4 mm

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Pjesët e rripit që do të jenë në kontakt me lëkurën nuk duhet ta gërvishtin, acarojnë ose dëmtojnë atë.
- Kufiri i lejuar i gabimit është 1–1.5 cm tek gjatësia dhe ± 1 mm tek gjerësia.
- Lëkura e rripit duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Lëkura duhet të ketë këto kërkesa cilësore:
 - o Duhet të jetë regjur mirë në të gjithë sipërfaqen.
 - o Faqja e jashtme duhet të jetë e pastër, e lëmuar dhe pa njolla.
 - o Ngjyrosja duhet të jetë uniforme në të gjithë sipërfaqen.
 - o Faqja e brendshme duhet të jetë e pastruar nga mbeturina e skanimit.
 - o Përkulshmëria e lëkurës duhet të jetë e lartë.
 - o Duhet të jetë e vajosur mirë.
 - o Duhet të jetë e ngjeshur.
 - o Duhet të ketë trashësi të barabartë në të gjithë sipërfaqen.
 - o Duhet të jetë kompakte.
 - o Lustra duhet të jetë e fiksuar mirë.
- Lëkura, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 17234-1:2015
 - b. EN ISO 17234 - 2:2011
 - c. EN ISO 4045 - 2018 (vlera limit e pH për lëkurët që kanë kontakt direkt dhe jo direkt me lëkurën është 3.5 - 7.5)
- Prodhuksi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Rripat duhet të mbështillen me letër të hollë. Rripi i mbështjellë me letër duhet futet në një qese polietileni i rrotulluar në vetvete.

Qeset me rripa të së njëjtës masë do të futen në një kuti kartoni me nga 50 rripa secila.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e rripit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja	EN ISO 17131:2012 Lëkurë - Identifikimi i lëkurës me mikroskop.
Trashësia	EN ISO 2589:2016 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike - Përcaktimi i trashësisë.
Regjia	EN ISO 17075-2017 Lëkurë - Përcaktimet kimike të përmbajtjes së kromit (VI) në lëkurë.

Lagështira	EN ISO 4684 :2005 Lëkurë - Përcaktimi i lëndë avulluese (volatile)
Hiri	EN ISO 4047:2002 Lëkurë - Përcaktimi i mbetjeve sulfate totale dhe i mbetjeve sulfate të patretshme në ujë.
Yndyra	EN ISO 4048:2008 Lëkurë - Provat kimike - Përcaktimi i lëndës së tretur në diklormetan dhe përmbajtja e acideve yndyrorë të lirë.
Lëndë larëse	EN ISO 4044:2017
Lëndë lëkurë	Lëkurë - Provat kimike - Përgatitja e mostrave për provat kimike.
Koeficienti i regjjes	
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	EN ISO 15700: 1998 Lëkurë - Testet e qëndrueshmërisë së ngjyrës -Qëndrueshmëria e ngjyrës në spërkatjen me ujë.
	EN ISO 11640: 2013 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në ciklet e fërkimit para-mbrapa.
	EN ISO 11642: 2012 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërisë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në ujë.
Zgjatimi deri në këputje	EN ISO 3376: 2011
Fortesia në këputje	Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i forcës në tërheqje dhe i përqindjes së zgjatimit.
Zgjatja me ngarkese	
Rezistenca ndaj plasjes së faqes	EN ISO 3378: 2006 Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në grisjen e bërë thërmia dhe indeksi i grisjes në thërmia.
pH	EN ISO 4045 - 2018
Azo ngjyrues	EN ISO 17234-1:2015 EN ISO 17234 - 2:2011

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

KOLAUDIMI

Policia e Shtetit ka të drejtën që të garantojë cilësinë e produktit final nëpërmjet një mekanizmi kontrolli që quhet *kolaudim*. Kolaudimi përfshin këto masa:

1. Verifikimi i fletë-analizës së tekstileve dhe lëkurës.
2. Matjet dhe provat fizike të aksesorëve të plotë ose elementëve individualë të tyre.
3. Krahimin e rezultateve të matjeve me specifikat e përcaktuara në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*.

Vetëm pasi të jenë bërë të gjitha verifikimet përkatëse nga grupi i kontrollit të cilësisë dhe rezultatet të kenë dalë pozitive, siç është parashikuar në kontratë dhe në dokumentin e

Specifikimeve Teknike, Policia e Shtetit do të bëjë pranimin e produktit përfundimtar. Artikujt konsiderohen të pranuar vetëm kur plotësohen të gjitha kërkesat e Specifikimeve Teknike.

GARANCIA

Afati i garancisë duhet të jetë 1 vit për artikujt që e kanë afatin e përdorimit 1 vit dhe të paktën 2 vjet për artikujt që kanë afatin e përdorimit mbi 2 vjet. Në rastet kur artikulli pëson defekt si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike të specifikuara në këtë dokument, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvendësimin e plotë të artikullit, pa pagesë, konform specifikimeve teknike në këtë dokument. Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet detyrimisht me deklaratën e garancisë. Afati i garancisë fillon në momentin e kolaudimit.

AUTORËSIA

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë pronë e Policisë së Shtetit dhe mund të përdoren vetëm nga strukturat e këtij institucioni. Kopjimi dhe shumëfishimi i Specifikimeve Teknike të këtyre artikujve është i ndaluar.

Dokumenti i Specifikimeve Teknike të kapitullit Aksesorë ka gjithsej 100 faqe.